



REPUBLICA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dërguar Prenjeno / Predato Received / Delivered	29-04	1	viti god year
Organ / Jësia Org / Unit	SKIMSHICK	2086 / 2021	113



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr. 164/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani anëtarë, si dhe Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, duke u bazuar në Aktgjykimin me numër A.nr.2584/2019, të datës 05.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, të pranuar me datën 18.03.2021 kanë shqyrtuar ankesën me numër A. Nr.485/2019, të datës 21.08.2019, të parashtruar nga ankuesi me adrese banimi rruga „Bekim Berisha-Abeja” Komuna e Prizrenit , kundër organit të punësimit Ministria e Administratës Publike, në çështjen juridike “ kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafi 1.5 i Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 29.04.2021, mori këtë:

V E N D I M

PËRFUNDON procedimi administrativ i iniciuar me ankesën me numër A.nr.485/2019, të datës 21.08.2019, të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi me datën 19.08.2019, për mes Postes se Kosovës, ka parashtruar ankesën me numër A.nr.485/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila ankesë është pranuar me datën 21.08.2019, me numër protokoli 3699/2019, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 03.09.2019, me numër protokoli 4142/2019, ka njoftuar ankuesin se Këshilli në mungese të korumit nuk mund të vendos lidhur me ankesën tuaj, dhe në bazë të dispozitave ligjore në fuqi, mund të hapni konfliktin administrativ.



Ankuesi i pakënaqur me njoftimin e datës 03.09.2019, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka hapur konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative, me datë 05.03.2021, me numër A.nr. 2584/2019, ka nxjerr Aktgjykim me të cilin ka aprovuar kërkesë padinë e paditësit, duke e anuluar njoftimin e datës 03.09.2019, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe duke e detyruar që në afatin prej tredhjet (30) të vendos lidhur me aneksen e ankuesit.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Aktgjykim me numër A.nr. 2584/2019, te datës 05.03.2021 e protokolluar numër protokolli 1248/2021 të datës 18.03.2021; Ankesën me numër A. Nr.485/2019, të datës 21.08.2019, të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimi i datës 03.09.2019 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursin e datës 13.06.2019; Vendimin me numër 15/2019 i datës 10.07.2019 për formimin e Komisionit për Vlerësimin e Kriteve; Propozimi i Ministrit të MPMS për fillimin e procedurave për emërimin e Kryeinspektorit në Inspektoratin e Punës, MPMS.; Vendimi me numër 12/59 i datës 21.01.2021 i Qeverisë në detyrë të Republikës së Kosovës; Shkresën e datës 19.04.2021 e Sekretarisë për mbështetje administrative e Komisioni për Vlerësimin e Kriteve,

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të bashkangjitura të lëndës konstatoi se objekti për të cilën ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankuesit shtë bërë i pamundur *sepse*:

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se ankuesi, ka aplikuar në konkursin e datës 13.06.2019 për pozitën 'Kryeinspektor në Inspektoratin e Punës', Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale i shpallur nga Ministria e Administratës Publike, i cili ka qene i hapur 15 dite për aplikim nga data 13.06.2019 deri me date 27.06.2019. Ankuesi i pakënaqur me mos përfshirjen në listën e ngushte nga Komisioni për Vlerësimin e Kriteve, ka parashtruar ankesë në Komisionin për ankesa për pozita te larta drejtuese. Komisionin për ankesa për pozita të larta drejtuese, me datë 31.07.2019 nxjerr vendimin Nr.2449, me të cilin e ka refuzuar ankesën e ankuesit. Ankuesi me datë me datën 21.08.2019, për mes Postes së Kosovës, ka parashtruar ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila ankesë është regjistruar me datën 21.08.2019, me numër protokolli 3699/2019, me pretendimet ankimore se Komisioni për Vlerësimin e Kriteve ka vepruar ne kundërshtim me legjislacionin ne fuqi lidhur me mos përfshirjen ne listën e shkurte me arsyetimin se i mungon përvoja menaxheriale.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka shqyrtuar dëshmitë e ofruara ne lende dhe ka konstatuar se Ministria e Punëve të Brendshme, respektivisht Sekretaria për mbështetje administrative e Komisioni për Vlerësimin e Kriteve, në shkresën e datës 19.04.2021 lidhur me procedurën e rekrutimit për pozitën „ Kryeinspektor në Inspektoratit e Punës” Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale e ka njoftuar Këshillin se kjo procedure është plotësuar me procedurë të transferimit, ndërsa Zyra e Personelit ne Inspektoratin e Punës me date 28.04.2021 ka dërguar ne Këshillin e pavarur Mbikëqyrës për shërbimin Civil, Vendimin me numër 12/59 te datës 21.01.2021 te



Qeverisë në detyrë të Republikës së Kosovës me te cilin vendim z.

i vazhdohet

mandati në pozitën 'Kryeinspektor në Inspektoratit e Punës'.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar dëshmitë e ofruara në lende ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ është bërë i pamundur, në bazë të dispozitës të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kot"*, sepse në rastin konkret nga shkresat e lëndës del se Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur me date 21.01.2021 nxjerr Vendim me numër 12/59 me te cilin vendim z.


i vazhdohet mandati në pozitën 'Kryeinspektor në Inspektoratit e Punës' Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale për një kohëzgjatje 4 vjeçare.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda Nr. A. Nr. 164/2021

Rushit KAJTAZI



Procesmbajtës

Malsore GASHI - BAJRAKTARI



Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- Arkivit të KPMSHCK-së,

